

▪ Punëdhënësi, i cili nuk është punëdhënës kryesor i të punësuarit, mban në burim një shumë të barabartë me dhjetë për qind (10%) të pagave për secilën periudhë tatimore.

Pensionet e paguara i nënshtrohen mbajtjes së tatimit në burim nga paguesi i pensioneve sipas shkallëve të parapara. Në dispozitat e mbajtjes në burim përfshihen edhe tatimi i mbajtur në burim në interes dhe të drejta pronësore, tatimi i mbajtur në burim në fitoret nga lotaria dhe lojërat e fatit, si dhe mbajtja në burim në pagesa të caktuara për jorezidentët.

10. Si realizohet pagesa e Tatimit për Veprimtaritë Afariste?

Secili tatimpagues i cili realizon apo akruon të ardhura nga veprimtaritë afariste, paguan tatimin çdo tre muaj në një llogari të caktuar nga Administrata Tatimore, në një bankë të licencuar nga BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik (15 prill, 15 korrik, 15 tetor, 15 janar).

Tatimpaguesi i cili ka të ardhura vjetore bruto prej 50.000 euro e me tepër dhe tatimpaguesi që zgjedhë vullnetarisht të deklarojë në baza reale, përveç kësteve tremujore, duhet që më së largu deri me 31 Mars të vitit vijues të dorëzojnë deklaratën vjetore për Tatimin në të Ardhurat Personale.

11. Cilët janë tatimpaguesit që duhet të dorëzojnë Deklaratën Vjetore?

Tatimpaguesit me të ardhura mbi 50.000 € dhe ata të cilët zgjedhin të deklarojnë në baza reale, kërkohet që të dorëzojnë deklaratën vjetore më së voni deri me 31 Mars të vitit vijues. Tatimpaguesit e tillë që kërkohet të dorëzojnë deklarata vjetore, janë të obliguar që këtë ta bëjnë edhe në tri periudha tjera pasuese dhe vetëm atëherë (pas tre viteve) nëse qarkullimi i tyre zbret nën 50.000 € në vit, deri me 1 Mars të vitit aktual, duhet të bëjnë kërkesë pranë ATK-së, për tu larguar nga kjo mënyrë e deklarimit. Tatimpaguesit që realizojnë të hyrat vetëm nga një burim (përfshijtur të ardhurat e afarizmit) nuk janë të obliguar të dorëzojnë deklaratën vjetore, përveç nëse këta tatimpagues zgjedhin vullnetarisht të deklarojnë në baza reale.

Pagesa e tatimit, siguron qëndrueshmëri të ekonomisë në vend!

Kontaktet e ATK-së

Nëse keni nevojë për më shumë informacione, ne ju inkurajojmë që të shqyrtoni ligjet dhe udhëzimet administrative përkatëse. Këto janë në dispozicion në faqen tonë të internetit www.atk-ks.org. Nëse nuk jeni në gjendje të gjeni përgjigje për pyetjet tuaja, stafi i ATK-së është në dispozicion për të ju ndihmuar, prandaj drejtohuni në zyrat më të afërta të ATK-së:

Ministria e Financave - Ministrovstvo Financ - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo

Telefonat: VJETOR DHE PAGESE PER TATIMIN NE TE ARDHURAT PERSONALE UNIREF

PD NJTM : 038/200 346 41

[1] Periudha e Deklarimit: [2] Numri Fisikal: Prishtina-1: 038/200-255-21 [3a] Numri Personal: [4] Emri i tatimpaguesit: [5] Adresa e tatimpaguesit: Prishtina-2: 038/200-255-02 [6] Telefoni: Prishtina-3: 038/200-255-17 [7] Vendors X: Nëse keni detyrë të punësuarit dhe detyrë të punësuarit për këtë periudhë. [8] Shtesa: Prizreni: 029/244-963 [9] Votëm pagesë

Peja: 039/432-812
Ferizaj: 0290/321-668 [47] Shuma obligative (Barteni shumën nga kutia [42]) [48] Shuma e tatimit të paguar
Gjilani: 0280/326-967
Mitrovica: 028/590-667
Gjakova: 0390/330-021
Zyra Qëndrore: 038/200-250-17

Unë deklaroj se faktet e raportuara në këtë deklaratë tatimore janë të vërteta.
Emri: **Linja e përbashkët pa pagesë:** 0800-80-800 [49] Shuma e tatimit të paguar
Pjesa e kontraktit

Nënshtimi dhe vula Numri i llogarit: 1000420070000373 [49] Shuma e tatimit të paguar
Adresa: Këndi i rrugëve Bill Clinton & Dëshmorët e Kombit
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel & Fax: +381 (0)38 200 250 17 & 200 250 07
Email: info@atk-ks.org; Web: www.atk-ks.org

Nr. Formës PD-A6 : Kon



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

PYETJE - PËRGJIGJE
PËR TATIMIN NË TË
ARDHURAT PERSONALE

Fletëpalosja me Pyetje dhe Përgjigje bazuar në Ligjin Nr. 03/L - 161 për Tatimin në të Ardhurat Personale, ka për qëllim Edukimin dhe Informimin e Tatimpaguesve për të drejtat dhe detyrimet e tyre, të cilat rrjedhin nga Tatimi në të Ardhurat Personale.

1. Cilët janë tatimpaguesit për Tatimin në të Ardhurat Personale ?

Sipas këtij Ligji Tatimpagues janë: personat fizik rezident dhe jo rezident, Ndërmarrjet afariste, Ortakëritë dhe Shoqëritë, të cilët pranojnë ose krijojnë të ardhura.

2. Kush është objekt i Tatimit në të Ardhurat Personale?

Objekt i tatimit për tatimpaguesin rezident janë të ardhurat e tatueshme nga burimi i të ardhurave nga Kosova dhe burimi i të ardhurave jashtë Kosovës. Objekt i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme nga të ardhurat që e kanë burimin në Kosovë.

3. Çka përfshihet te të Ardhurat Bruto?

Të ardhurat bruto nënkuptojnë të gjitha të ardhurat që janë pranuar vërtetë apo në mënyrë konstruktive nga burimet vijuese: të ardhurat nga afarizmi, pagat, qiratë, përdorimi i pasurisë së paprekshme, Interesi që rezultojnë nga shitja e pasurisë kapitale, të ardhurat zëvendësuese, fitimet kapitale që rezultojnë nga një rritje apo ulje në vlerën e aksioneve, fitimet kapitale, fitoret në Lojërat e Fatit, si dhe Pensionet e paguara nga një punëdhënës i përparshëm.

Rreth 30% e të hyrave të ATK-së vijnë nga Tatimi në të Ardhurat Personale

4. Cilat janë të Ardhurat e Përrjashtuara ?

Nga Tatimi në të Ardhura Personale, përjashtohen të ardhurat në vijim: Rrogat e pranuar nga përfaqësuesit e huaj diplomatik e konsular dhe personeli i jashtëm i Ambasadave apo Zyrave të Ndërlidhjes së shteteve të huaja në Kosovë, siç është përcaktuar në legjislacionin e aplikueshëm mbi vendosjen dhe funksionimin e zyrave ndërlidhëse dhe shërbimeve diplomatike në Kosovë;

Rrogat e pranuar nga përfaqësuesit e jashtëm, zyrtarët e jashtëm dhe punonjësit e jashtëm të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare që janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe kanë marrë dhe mbajtur statusin e përfitimit publik sipas legjislacionit të tillë; Gjithashtu, janë të përjashtuara rrogat e pranuar nga agjencionet donatore, të kontraktorëve të tyre apo të fondacioneve që realizojnë, si dhe rrogat e marra nga personeli i jashtëm i KFOR-it; PCN, EULEX-i, etj.

5. Cilat janë të Ardhurat nga Paga ?

Në të ardhurat bruto nga pagat përfshihen: Rrogat e paguara nga punëdhënësi për punëtorin, bonuset, provizionet dhe format e tjera të kompensimit për punëtorin, të ardhurat e fituara nga puna e përkohshme, premitë e sigurimit shëndetësor dhe të jetës, falja e huas së punonjësit ose e obligimit të punëdhënësit, pagesa e shpenzimeve personale të punonjësit nga punëdhënësi, etj

6. Cilat janë të Ardhurat nga Aktivitetet Afariste?

Të ardhurat bruto nga veprimtaritë afariste nënkuptojnë pranimet bruto të gjeneruara nga një person apo entitet, përveç personave juridik për qëllime të këtij ligji, të angazhuar në veprimtari të tilla. Në të Ardhurat nga Aktivitetet afariste përfshihen: të ardhurat nga qiratë, të ardhurat nga pasuria e paprekshme, të ardhurat nga Interesi, si dhe të ardhurat tjera përfshirë dhuratat.

7. Çka përfshihet në Shpenzimet Afariste të Lejueshme?

Për bizneset, të cilat deklarohen në baza reale apo ato që kanë zgjedhur vullnetarisht të deklarohen në baza reale, lejohen si zbritje nga të ardhurat e përgjithshme të krijuara nga pasuria e paprekshme, qiratë apo aktivitetet afariste, shpenzimet e paguara ose të shkaktuara gjatë periudhës tatimore që janë tërësisht, vetëm dhe drejtpërdrejt të lidhura me aktivitetet e tilla që gjenerojnë të ardhura, përfshirë primet për sigurim shëndetësor, të paguara në interes të punëtorit dhe ato të varura që duhet të përfshihen në polisën e të punësuarit.

Në dispozitat e përgjithshme përfshihen:

- Shpenzimet e reprezentacionit;
- Shpenzimet e borxhit të keq;
- Shpenzimet afariste të udhëtimit;
- Pagesat për personat e lidhur;
- Zhvlerësimi i bagëtive;
- Riparimet dhe përmirësimet;
- Amortizimi;
- Shpenzimet kërkimore dhe zhvillimore;
- Humbjet tatimore;
- Shpenzimet e qirasë;
- Zbritjet e lejuara për kontribute bamirëse;
- Shpenzimet edukative/arsimore dhe trajnuese, etj.

8. Cilat janë kërkesat për Libra dhe Regjistrime?

Tatimpaguesi me të ardhura bruto vjetore nga aktivitetet afariste që i tejkalon 50.000 euro për periudhën tatimore, si dhe ortakëritë dhe grupet e personave, duhet të mbajnë librat dhe regjistrimet sipas standardeve të Kontabilitetit. Ndërsa tatimpaguesi me të ardhura bruto vjetore prej 50.000 euro apo më pak, i cili nuk zgjedh të përgatisë librat dhe regjistrimet në baza reale, duhet të mbajnë librat dhe regjistrimet si në vijim:

- Një libër të shitjes në të cilin të gjitha shitjet dhe kthimet duhet të regjistrohen;
- Një libër të blerjes në të cilin të gjitha blerjet dhe kthimet duhet të regjistrohen;
- Një ditar të pranimeve në para të gatshme (kesh) dhe një ditar të pagesave në para të gatshme (kesh) që lidhen me librin e shitjes dhe librin e blerjes.

9. Kur dhe si duhet të mbahet tatimi në burim?

Secili punëdhënës është përgjegjës të mbaj në burim tatimin nga pagat e tatueshme të paguara punëtorëve të tij gjatë çdo periudhe të listë pagesës për të cilën pagat janë paguar.

- Punëdhënësi, i cili është përzgjedhur si punëdhënës kryesor i të punësuarit, mbanë në burim një shumë sipas shkallëve tatimore për secilën periudhë tatimore;

